# Republika e Kosovës

## Republika Kosova - Republic of Kosovo

*Qeveria - Vlada - Government*

**Nr. 01/76**
**Datë: 21.11.2018**

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 14/2017, me Rregulloren nr. 15/2017, me Rregulloren nr. 16/2017, me Rregulloren nr. 07/2018 dhe me Rregulloren nr. 22/2018, si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 21 nëntor 2018, nxjerr këtë:

## V E N D I M

1. Vendoset masa prej 100% për produktet e importuara me origjinë nga Serbia dhe Bosnja dhe Hercegovina.

2. Pavarësisht origjinës së mallit të paraparë në paragrafin 1 të këtij vendimi, masa prej 100 % nuk aplikohet për markat e njohura tregtare të vendeve tjera cilat prodhohen në Serbi dhe Bosnje e Hercegovinë, të cilat janë pjesë e aneksit të bashkangjitur me këtë vendim.

3. Obligohet Dogana e Republikës së Kosovës që të ndalojë importin dhe hyrjen në treg të të gjitha produkteve të cilat në etiketën apo deklaracionin e tyre kanë përmbajtjen e: Importues / Distributor / Përfaqësues / Prodhues / apo edhe ndryshe, për dhe në "Kosovë e Metohi", "Kosovo Unmik", "Kosovo 1244", "Kosovo Rezoluta 1244" sikurse edhe ato në të cilat përdorin vetëm emrat e qyteteve pa emrin e shtetit, apo edhe çdo emërtim tjetër në kundërshtim me emërtimin kushtetues të Republikës së Kosovës.

4. Obligohet MTI - Inspektorati i Tregut dhe Inspektoratet Komunale që të obligojnë të gjithë operatorët ekonomik t'i largojnë nga tregu të gjitha produktet të cilat në etiketën apo deklaracionin e tyre kanë përmbajtjen e: Importues / Distributor / Përfaqësues / Prodhues / apo edhe ndryshe, për dhe në "Kosovë e Metohi", "Kosovo Unmik", "Kosovo 1244", "Kosovo Rezoluta 1244" sikurse edhe ato në të cilat përdorin vetëm emrat e qyteteve pa emrin e shtetit, apo edhe çdo emërtim tjetër në kundërshtim me emërtimin kushtetues të Republikës së Kosovës.

5. Obligohet Dogana e Kosovës, Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë si dhe institucionet tjera relevante të zbatojnë masa të njëjta ndaj Serbisë dhe Bosnjës e Hercegovinës për sa i përket dokumenteve dhe certifikatave që kërkohen për tregti (Dokumentet dhe certifikatat i referohen analizave të testimit, analizave laboratorike, certifikatave sanitare dhe fito-sanitare, barkodit të produkteve kosovare).

6. Obligohet Ministria e Financave, Dogana e Kosovës, Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë si dhe institucionet tjera relevante për zbatimin e këtij vendimi, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

7. Me këtë vendim shfuqizohet vendimi Qeverisë së Republikës së Kosovës **me nr. 01/74 i datës 06.11.2018.**

8. Ky Vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Ramush HARADINAJ**

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë

# ANEKSI

| NR | Emri i subjektit | Brendi | Prodhuar në |
|---|---|---|---|
| 1 | Coca Cola HBC | Coca cola | Serbi |
| 2 | Ymalko | Ytong (Xella)blloka | Serbi |
| 3 | Meridian Corporation | Rouch-Bravo | Serbi |
| 4 | Elkos SHPK | Henkel/Persil | Serbi |
| 5 | Lactalis shpk | Dukat | Bosne |
| 6 | Meridian Corporation | Tuborg | Serbi |
| 7 | Gorenje Niti-Tiki | Gorenje | Serbi |
| 8 | Delfin LTD | Meggle | Bosne |
| 9 | Fluidi | Jaffa - PIJE JO ALKOOLIKE | Serbi |

**Nr. 02/76**
**Datë: 21.11.2018**

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 14/2017, me Rregulloren nr. 15/2017, me Rregulloren nr. 16/2017, me Rregulloren nr. 07/2018 dhe me Rregulloren nr. 22/2018, si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 21 nëntor 2018, nxjerr këtë:

## V E N D I M

1. Aprovohet Draft-Agjenda për takimin e përbashkët të dy qeverive, asaj të Republikës së Kosovës dhe të Republikës së Shqipërisë, e cila do të mbahet në Pejë, më 26 nëntor 2018.

2. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Ramush HARADINAJ**

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**
*Qeveria - Vlada - Government*

**Nr. 03/76**
**Datë: 21.11.2018**

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 29 të Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, me ndryshimet dhe plotësimet e bëra, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 14/2017, me Rregulloren nr. 15/2017, me Rregulloren nr. 16/2017, me Rregulloren nr. 07/2018 dhe me Rregulloren nr. 22/2018, si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 21 nëntor 2018, nxjerr këtë:

## V E N D I M

1. Ndahen mjete financiare në vlerë 120,000.00 euro, për takimin e përbashkët të dy qeverive, asaj të Republikës së Kosovës dhe të Republikës së Shqipërisë, e cila do të mbahet në Pejë, më 26 nëntor 2018.

2. Mjetet nga pika 1. e këtij vendimi ndahen nga Shpenzimet e Paparashikuara, nën programi Shpenzimet e Paparashikuara me kod 13100, kategoria e Shpenzimeve të Rezervës. Këto mjete barten në nën programin 10700 Kabineti i Kryeministrit, në kategorinë Mallra dhe Shërbime.

3. Obligohet Ministria e Financave dhe Zyra e Kryeministrit për zbatimin e këtij vendimi.

4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Ramush HARADINAJ**

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**
*Qeveria - Vlada - Government*

---

**Nr. 04/76**
**Datë: 21.11.2018**

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 14/2017, me Rregulloren nr. 15/2017, me Rregulloren nr. 16/2017, me Rregulloren nr. 07/2018 dhe me Rregulloren nr. 22/2018, si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 21 nëntor 2018, nxjerr këtë:

## V E N D I M

1. Ndahen mjete financiare në vlerë 600,000.00 (gjashtëqindmijë) euro, për Zjarrëfikësit e Republikës së Kosovës.

2. Obligohet Ministria e Punëve të Brendshme, në bashkëpunim me komunat, që më së largu deri me datën 10 dhjetor t'i sjellin listat e specifikuara për çdo të punësuar, duke mos kaluar shumën e paraparë me këtë vendim.

3. Obligohet Ministria e Financave dhe Ministria e Punëve të Brendshme për zbatimin e këtij vendimi.

4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Ramush HARADINAJ**

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë

# Republika e Kosovës
## Republika Kosova - Republic of Kosovo
*Qeveria - Vlada - Government*

**Nr. 05/76**
**Datë: 21.11.2018**

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 14/2017, me Rregulloren nr. 15/2017, me Rregulloren nr. 16/2017, me Rregulloren nr. 07/2018 dhe me Rregulloren nr. 22/2018, si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 21 nëntor 2018, nxjerr këtë:

## V E N D I M
### Për pezullim të Vendimeve të Qeverisë

1. Pezullohen të gjitha vendimet e Qeverisë së Republikës së Kosovës për kthimin e pronave shoqërore të AKP-së Komunave të Kosovës për qëllim të realizimit të interesit publik të cilat i janë drejtuar Agjencisë Kosovare të Privatizimit nga ana e Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, deri në marrjen e një vendimi tjetër.

2. Anulohen të gjitha Vendimet e Qeverisë së Republikës së Kosovës për kthimin e pronave shoqërore të AKP-së Komunave të Kosovës për qëllim të realizimit të interesit publik të cilat i janë drejtuar Agjencisë Kosovare të Privatizimit e për të cilat verifikohet se ka Kontrata të Shitjes, apo në të cilat ka masa të përkohshme nga Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës.

3. Anulohet vendimi i Qeverisë nr. 05/57 i datës 17.07.2018

4. Vendimet e Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 10/51 i datës 12.06.2018; Vendimi nr. 01/53 i datës 26.06.2018 dhe Vendimi nr. 15/75 i datës 13.11.2018 mbeten në fuqi.

5. Me qëllim të sqarimeve të mëtejme lidhur me kërkesat e Komunave themelohet Grupi Punues në këtë përbërje:

   5.1. Sekretari i Përgjithshëm në MAPL, kryesues;
   5.2. Koordinatori për Reforma Shtetërore në ZKM, bashkë kryesues;
   5.3. Drejtori i Departamentit Ligjor në MAPL, anëtar;
   5.4. Drejtori i Departamentit Ligjor në MD, anëtar;
   5.5. Asociacioni i Komunave të Kosovës, anëtar;
   5.6. Drejtori i Zyrës Ligjore në ZKM, anëtar;
   5.7. Drejtori i Sekretariatit Koordinues të Qeverisë në ZKM, anëtar;
   5.8. Ftohet AKP që ta dërgojë një përfaqësues në Grup Punues.

6. Grupi Punues nga pika 5. e këtij vendimi të paraqesë Raport me shkrim dhe rekomandime lidhur me këtë çështje brenda një jave.

7. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Ramush HARADINAJ**

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**
*Qeveria - Vlada - Government*

---

**Nr. 06/76**
**Datë: 21.11.2018**

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 14/2017, me Rregulloren nr. 15/2017, me Rregulloren nr. 16/2017, me Rregulloren nr. 07/2018 dhe me Rregulloren nr. 22/2018, si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 21 nëntor 2018, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

1. Aprovohet Projektligji për Ratifikimin e Marrëveshjes për Bashkëfinancimin e Bursave në Nivel të Studimeve Master ndërmjet Ambasadës së Francës në Prishtinë dhe Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë.

2. Projektligji nga pika 1. e këtij vendimi i dërgohet Kuvendit të Republikës së Kosovës për shqyrtim dhe miratim.

3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Ramush HARADINAJ**

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë

# Republika e Kosovës

## Republika Kosova - Republic of Kosovo

*Qeveria - Vlada - Government*

**Nr. 07/76**
**Datë: 21.11.2018**

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 14/2017, me Rregulloren nr. 15/2017, me Rregulloren nr. 16/2017, me Rregulloren nr. 07/2018 dhe me Rregulloren nr. 22/2018, si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 21 nëntor 2018, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

1. Aprovohet Projektligji për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale.

2. Projektligji nga pika 1. e këtij vendimi i dërgohet Kuvendit të Republikës së Kosovës për shqyrtim dhe miratim.

3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Ramush HARADINAJ**

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**
***Qeveria - Vlada - Government***

**Nr. 08/76**
**Datë: 21.11.2018**

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 15 dhe nenit 16 të Ligjit të Buxhetit për vitin 2018, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 14/2017, me Rregulloren nr. 15/2017, me Rregulloren nr. 16/2017, me Rregulloren nr. 07/2018 dhe me Rregulloren nr. 22/2018, si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 21 nëntor 2018, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

1. Aprovohet kërkesa e Ministrit të Financave për kursime, ndarje, transfere dhe rialokime buxhetore ndërmjet kategorive të shpenzimeve të organizatave buxhetore për vitin 2018, sipas tabelave të bashkëngjitura.

2. Obligohet Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Ramush HARADINAJ**

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë

TABELA 2. NDARJET

# Niveli qendror

| Kodi org. | Organizata buxhetore | Kodi i nën programit | Nenprogrami | Kodi i projektit | Emri i projektit | Pagat dhe Mëditjet | Mallrat dhe Sherbimet | Shpenzimet Komunale | Subvencione dhe transfere | Shpenzimet Kapitale | Totali |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 220 | Shërbimi Spitalor Klinik Univerzitar I Kosoves | 70000 | Sherbimet Rajonale te Kujdesit Dytesor Shendetesor | | | | 305,000 | | | | 305,000 |
| 220 | Shërbimi Spitalor Klinik Univerzitar I Kosoves | 70100 | QKUK- Shërbimi Tercial Shëndetsor | 15709 | Modernizimi i Infrastruktures te Objekteve Spitalore te programeve Buxhetore te SHSKUK | | 400,000 | | | 241,265 | 641,265 |
| 221 | Shërbimi Spitalor Klinik Univerzitar I Kosoves | 70101 | QKUK- Shërbimi Tercial Shëndetsor | 15201 | Ndertimi I nderteses se mjekesise se sportit me Kliniken e Fiziatrisë | | | | | 700,000 | 700,000 |
| | | | | | | | | | | | - |
| | | | Total Sherbimi Spitalor dhe Klinik Universitar I Kosoves | | | - | 705,000 | - | - | 941,265 | 1,646,265 |
| 207 | Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve | 81500 | Mbrojtja Ruajtja e Trashëgimisë Kulturore | | | | | | 37,791 | | 37,791 |
| | | | | | | | | | | | - |
| | | | Total Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve | | | - | - | - | 37,791 | - | 37,791 |
| 213 | Ministria e Zhvillimit Ekonomik | 11413 | Zyra e Ministrit | | | 10,000 | | | | | 10,000 |
| | | | | | | | | | | | - |
| | | | Total Ministria e Zhvillimit Ekonomik | | | 10,000 | - | - | - | - | 10,000 |
| 214 | Ministria e Punëve të Brendshme | 30000 | Sherbimet Administrative (Policia e Kosoves) | | | 1,100,000 | | | | | 1,100,000 |
| | | | | | | | | | | | - |
| | | | Total Ministria e Punëve të Brendshme | | | 1,100,000 | - | - | - | - | 1,100,000 |
| 216 | Ministria e Punëve të Jashtme | 14300 | Ambasadat | | | | 1,157,575 | | | | 1,157,575 |
| 216 | Ministria e Punëve të Jashtme | 11316 | Administrata Qendrore | | | | 150,000 | | | | 150,000 |
| 216 | Ministria e Punëve të Jashtme | 11416 | Zyra e Ministrit | | | | 150,000 | | | | 150,000 |
| | | | | | | | | | | | - |
| | | | Total Ministria e Punëve të Jashtme | | | - | 1,457,575 | - | - | - | 1,457,575 |
| 242 | Univerziteti i Prishtinës | 90400 | Universiteti i Prishtinës | | | | 150,000 | | | | 150,000 |
| | | | | | | | | | | | - |
| Total Univerziteti i Prishtinës | | | | | | - | 150,000 | - | - | - | 150,000 |
| 250 | Keshilli Prokurororial i Kosoves | 33500 | Prokuroriẗë dhe Administrata | | | 90,000 | | | | | 90,000 |
| 250 | Keshilli Prokurororial i Kosoves | 33000 | Njesia per mbrojtjen dhe ndihme viktimave | | | 10,000 | | | | | 10,000 |
| | | | | | | | | | | | - |
| | | | Total Keshilli Prokurororial I Kosoves | | | 100,000 | - | - | - | - | 100,000 |
| 328 | Këshilli Gjygjsor i Kosovës | 33300 | Sekretariati I keshillit gjyqesor | | | 100,000 | | | | | 100,000 |
| | | | | | | | | | | | - |
| | | | Total Këshilli Gjygjsor i Kosovës | | | 100,000 | - | - | - | - | 100,000 |
| 253 | Agjencioni për Menaxhimin e Komplekseve M | 27900 | Agjencia për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale | | | 3,300 | | | | | 3,300 |
| | | | | | | | | | | | - |
| | | | Total Agjencioni për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale | | | 3,300 | - | - | - | - | 3,300 |
| | | | | | | | | | | | - |
| | | | Total Ndarjet | | | 1,313,300 | 2,312,575 | - | 37,791 | 941,265 | 4,604,931 |

| | | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 214 | Ministria e Punëve të Brendshme | 30400 | Sherbimet e Mbështetjes (Policia e Kosovës) | 10 | 14250 | Modernizimi dhe mirembajtja e sistemeve eletronike të PK-së | | | | | 170,000 | 170,000 |
| | | | | | | | | | | | | - |
| | | | | | | Total Ministria e Punëve të Brendshme | - | 1,811,903 | - | - | (1,811,903) | - |
| 241 | Agjencia për Ndihmë Juridike Falas | 32600 | Agjencia për Ndihmë Juridike Falas | 10 | | | | 3,500 | (3,500) | | | - |
| | | | | | | | | | | - | - | - |
| | | | | | | Total Agjencia per Ndihmë Juridike Falas | - | 3,500 | (3,500) | - | - | - |
| 242 | Univerziteti i Prishtinës | 90400 | Univerziteti i Prishtinës | | | | | 80,000 | (80,000) | - | | - |
| | | | | | | | | | | - | - | - |
| | | | | | | Total Univerziteti i Prishtinës | - | 80,000 | (80,000) | - | - | - |
| 317 | Autoriteti i Aviacionit Civil | 45400 | Autoriteti i Aviacionit Civil | 10 | 45400 | Autoriteti i Aviacionit Civil | | 2,500 | (2,500) | | | - |
| | | | | | | | | | | - | - | - |
| | | | | | | Total Autoriteti i Aviacionit Civil | - | 2,500 | (2,500) | - | - | - |
| 328 | Këshilli Gjygjsor i Kosovës | 33300 | Sekretariati i KGJK | 10 | | | | | | 150,000 | | 150,000 |
| 328 | Këshilli Gjygjsor i Kosovës | 33300 | Sekretariati i KGJK | 10 | 15247 | Ndërtimi i objektit të Gjykatës në Fushë Kosovë | | | | | (150,000) | (150,000) |
| | | | | | | | | | | | | - |
| | | | | | | Total Këshilli Gjygjsor i Kosovës | - | - | - | 150,000 | (150,000) | - |
| | | | | | | | | | | | | |
| | | | | | | **Total Transfere dhe Rialokime nga fondi 10** | - | 5,522,720 | (111,000) | 2,702,881 | (8,114,601) | - |

| Rialokimi i projekteve nga fondi 24 | | | | | | | Pagat dhe Mëditjet | Mallrat dhe Sherbimet | Shpenzimat Komunale | Subvencione dhe transfere | Shpenzimet Kapitale | Totali |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 207 | Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit | 80200 | Arritjet sportive | 24 | 14226 | Stadiumi Nacional i Futbollit | | | | | (1,500,000) | (1,500,000) |
| 207 | Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit | 80200 | Arritjet sportive | 24 | 14223 | Renovimi i Stadiumit të Qytetit në Prishtinë | | | | | 1,500,000 | 1,500,000 |
| | | | | | | | | | | | | |
| Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit | | | | | | | - | - | - | - | - | - |
| 205 | Ministria e Infrastrukturës | 418 | Rehabilitimi i Rrugeve | 24 | 10438 | Zgjerimi dhe rehabilitimi u rruges magjistrale Prishtine -Mitrovicë | | | | | (1,000,000) | (1,000,000) |
| 205 | Ministria e Infrastrukturës | 416 | Mirembajtja e Rrugëve | 24 | 13004 | Mirembajtja Investive e Rrugëve | | | | | 1,000,000 | 1,000,000 |
| | | | | | | | | | | | | |
| Total Ministria e Infrastrukturës | | | | | | | - | - | - | - | - | - |

# Republika e Kosovës
## Republika Kosova - Republic of Kosovo
*Qeveria - Vlada - Government*

**Nr. 09/76**
**Datë: 21.11.2018**

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 9 paragrafi 1 të Kodit të Doganave dhe Akcizës Nr. 03/L-109, si dhe në mbështetje të Marrëveshjes kuadër, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës, për bashkëpunimin në nxitjen dhe lehtësimin e tregtisë" duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 14/2017, me Rregulloren nr. 15/2017, me Rregulloren nr. 16/2017, me Rregulloren nr. 07/2018 dhe me Rregulloren nr. 22/2018, si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 21 nëntor 2018, nxjerr këtë:

## V E N D I M

1. Obligohet Dogana e Kosovës që të hapë zyrën doganore të Republikës së Kosovës, që të kryejë procedura doganore të transitit të mallrave që importohen përmes Terminaleve të Tragetit, Anijeve dhe Kontejnerëve në portin e Durrësit, dhe që kanë destinacion final tregun e Republikës së Kosovës.

2. Për këtë qëllim, zyrtarët/oficerët doganorë të Doganës së Kosovës operojnë në Terminaleve Tragetit, Anijeve dhe Kontejnerëve në portin e Durrësit, për procedurat e evidentimit, regjistrimit dhe transitin e mallrave për importuesit kosovar.

3. Punonjësit doganor të Doganës së Kosovës, bashkëpunojnë me zyrtarët e Doganës Shqiptare në kryerjen e funksioneve të tyre.

   Në rastet kur gjatë kontrolleve të kryera nga personeli zyrtar i Doganës së Kosovës, konstatohen mallra të ndaluara apo trafikim i qenieve njerëzore, njoftohen menjëherë organet e Policisë dhe ato Doganore Shqiptare.

4. Njihen licencat e agjencive doganore të Republikës së Shqipërisë, me qëllim kryerjen e deklarimit të transitit në Republikën e Kosovës sipas marrëveshjes për bashkëpunimin në nxitjen dhe lehtësimin e tregtisë, përfshirë vendosjen e garancisë për borxhin e mundshëm në këtë regjim.

   Pas dorëzimit zyrtar të listës dhe kopjeve të licencave nga Dogana e Shqipërisë, këto agjenci regjistrohen pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave të Kosovës.

   Dogana e Kosovës, me qëllim njohjen dhe regjistrimin nga Dogana e Shqipërisë, dërgon pranë kësaj të fundit, listën dhe kopje të licencave të agjencive doganore të Republikës së Kosovës me qëllim kryerjen e deklarimit të transitit të mallrave nëpër territorin e Republikës së Shqipërisë që kanë destinacion final Republikën e Kosovës.

5. Obligohet Dogana e Kosovës që të sjellë aktin nënligjor për zbatimin te këtyrë procedurave doganore.

6. Obligohet Ministria e Financave dhe Dogana e Kosovës për zbatimin e këtij vendimi, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

7. Ky Vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Ramush HARADINAJ**

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**
*Qeveria - Vlada - Government*

---

**Nr. 10/76**
**Datë: 21.11.2018**

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 14/2017, me Rregulloren nr. 15/2017, me Rregulloren nr. 16/2017, me Rregulloren nr. 07/2018 dhe me Rregulloren nr. 22/2018, si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 21 nëntor 2018, nxjerr këtë:

## V E N D I M

1. Për përmbushjen e kontributit vjetor të Qeverisë së Republikës së Kosovës në Qendrën Rajonale të Nismës Rajonale për Migrim, Azil dhe Refugjat (MARRI), me seli në Shkup, ndahen mjete financiare për vitin 2018 në vlerë prej 17.580 (shtatëmbëdhjetëmijë e pesëqind e tetëdhjetë) euro.

2. Shuma në vlerën e sipërpërmendur ndahet nga kategoria e Mallrave dhe Shërbimeve, nga programi Shërbimet e Administratës Qendrore - MPB me kodin 11314, dhe barten në xhirollogarinë IBAN: MK 07300702000289866 EUR, S.W.I.F.T.:KOBSMK2X, Komercijalna Banka A.D. Skopje.

3. Obligohet Ministria e Punëve të Brendshme dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Ramush HARADINAJ**

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**
*Qeveria - Vlada - Government*

**Nr. 11/76**
**Datë: 21.11.2018**

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 14/2017, me Rregulloren nr. 15/2017, me Rregulloren nr. 16/2017, me Rregulloren nr. 07/2018 dhe me Rregulloren nr. 22/2018, si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 21 nëntor 2018, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

1. Aprovohet propozimi i Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, që FC Prishtinës t'i jepet në shfrytëzim afatgjatë prona e Qeverisë së Republikës së Kosovës.

2. Prona e paluajtshme e Qeverisë së Republikës së Kosovës që jepet në shfrytëzim ka këto karakteristika: Parcela me nr. 1197-2, sipërfaqja 100000 m2, Zona Kadastrale Bernicë e Poshtme, Prishtinë, Certifikata për të drejtat e pronësisë Nr. P-71914024-01197-2 e dt. 18.10.2018.

3. Afati kohor për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Qeverisë së Republikës së Kosovës, të cekur në pikën 2. të këtij vendimi është 40 (dyzet) vjet.

4. Prona e paluajtshme e cekur në pikën 2. të këtij vendimi, jepet në shfrytëzim pa kompensim.

5. Prona e paluajtshme e cekur në pikën 2. të këtij vendimi nuk duhet të bien ndesh me pronat që aktualisht shfrytëzohen nga KF Kosova.

6. Mënyra dhe kushtet e shfrytëzimit të pronës së paluajtshme do të përcaktohen me kontratë, e cila lidhet dhe nënshkruhet në mes të Ministrit të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe përfaqësuesit të shfrytëzuesit.

7. Prona e paluajtshme e Qeverisë së Republikës së Kosovës që jepet në shfrytëzim, e përshkruar në pikën 2. të këtij vendimi, duhet të evidentohet në librat kadastralë të Komunës përkatëse.

8. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Ramush HARADINAJ**

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë

# Republika e Kosovës

**Republika Kosova - Republic of Kosovo**

*Qeveria - Vlada - Government*

**Nr. 12/76**
**Datë: 21.11.2018**

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 4, 9, 10, 44 dhe nenit 45 të Ligjit nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 14/2017, me Rregulloren nr. 15/2017, me Rregulloren nr. 16/2017, me Rregulloren nr. 07/2018 dhe me Rregulloren nr. 22/2018, si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 21 nëntor 2018, nxjerr këtë:

**V E N D I M P R E L I M I N A R**

1. Aprovohet shpronësimi për interes publik i pronave të paluajtshme (ish shoqërore) të pronarëve dhe zotëruesve të interesit të cilat preken nga realizimi i Projektit "Renovimi dhe Ndërtimi i Objekteve për nevoja të "Selisë Qendrore të Federatës së Futbollit të Kosovës" (FFK), Zona Kadastrale Prishtinë, Komuna Prishtinë, sipas tabelave të përshkruar nga evidencat kadastrale përkatëse për titullarët e pronave të paluajtshme, pozitën e tyre në kuadër të projektit të interesit publik si dhe sipërfaqeve të tyre, të cilat tabela janë pjesë përbërëse e këtij vendimi.

2. Obligohet Departamenti i Shpronësimit/MMPH që brenda 5 (pesë) ditëve të punës, pas nënshkrimit të këtij vendimi preliminar, t'i njoftojë pronarët dhe pretenduesit e tokave të cilat do të shpronësohen dhe brenda afatit prej 10 ditëve të punës pas miratimit të njëjtin ta shpallë në Gazetën Zyrtare të Kosovës, si dhe në një gazetë me tirazh të madh në Kosovë.

3. Kundër këtij vendimi apo cilës do pjesë të tij kanë të drejtë të paraqesin ankesë brenda tridhjetë (30) ditëve kalendarike në Gjykatën Kompetente, subjekti kërkues dhe cili do person i cili është pronar ose zotërues i interesit, në pronën e paluajtshme të prekur nga ky vendim.

4. Për zbatimin e këtij Vendimi obligohen Departamenti i Shpronësimit (MMPH), Ministria e Financave dhe Federata e Futbollit të Kosovës (FFK).

5. Vendimi hyn në fuqi në datën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe në një gazetë me tirazh të madh në Kosovë.

**Ramush HARADINAJ**

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**
***Qeveria - Vlada - Government***

**Nr. 13/76**
**Datë: 21.11.2018**

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 4, 8, 44 dhe nenit 45 të Ligjit nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 14/2017, me Rregulloren nr. 15/2017, me Rregulloren nr. 16/2017, me Rregulloren nr. 07/2018 dhe me Rregulloren nr. 22/2018, si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 21 nëntor 2018, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

1. Aprovohet shqyrtimi i mëtejmë i kërkesës për shpronësim për interes publik i pronave të paluajtshme të pronarëve dhe zotëruesve të interesit të cilat preken nga ndërtimi i Autostradës Prishtinë-Pejë, Segmenti Kijevë-Klinë-Zahaq, zonat kadastrale: Kijevë, Komuna Malishevë, zonat kadastrale: Çabiq, Zabërgje, Gllarevë, Gjurgjevik, Dresnik, Dollc, Gremnik, Novosellë e Zajmit, Grabanicë, Drenoc, Potërq i Poshtëm, Potërq i Epërm, Komuna Klinë dhe zonat kadastrale Jabllanicë, Kliqinë, Leshan, Gllaviqicë dhe Ramun të Komunës së Pejës, sipas tabelave të përshkruar nga evidencat kadastrale përkatëse për titullarët e pronave të paluajtshme, pozitën e tyre në kuadër të projektit të interesit publik si dhe sipërfaqeve të tyre, të cilat tabela janë pjesë përbërëse e këtij vendimi.

2. Vlera e kompensimit të pronave do të caktohet nga Ministria e Financave, konform Ligjit nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205 dhe Udhëzimit Administrativ nr.02/2015 "Për zbatimin e metodave dhe kritereve teknike të vlerësimit që do të përdoren për përllogaritjen e shumës së kompensimit për pronën e paluajtshme që shpronësohet dhe dëmeve që kanë të bëjnë me shpronësimin".

3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen Departamenti i Shpronësimit (MMPH), Ministria e Infrastrukturës dhe Ministria e Financave.

4. Vendimi hyn në fuqi në datën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe në një gazetë me tirazh të madh në Kosovë.

**Ramush HARADINAJ**

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Oeverisë

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**
*Qeveria - Vlada - Government*

**Nr. 14/76**
**Datë: 21.11.2018**

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 53 të Ligjit Nr. 05/L-031 Për Procedurën e Përgjithshme Administrative, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 14/2017, me Rregulloren nr. 15/2017, me Rregulloren nr. 16/2017, me Rregulloren nr. 07/2018 dhe me Rregulloren nr. 22/2018, si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, duke shqyrtuar kërkesën e MMPH-së, nr. prot. 6743, datë 19.11.2018, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 21 nëntor 2018, nxjerr këtë:

**V E N D I M**
**për anulimin, ndryshimin dhe plotësimin e pjesërishëm të Vendimit të Qeverisë së Kosovës Nr. 03/41 datë 13.04.2018**

1. Ndryshohet pika 1. e Vendimit të Qeverisë së Kosovës Nr. 03/41 datë 13.04.2018, me të cilin janë shpallur me interes të veçantë publik pronat e paluajtshme të pronarëve dhe zotëruesve të interesit të cilat preken nga realizimi i Projektit "Ndërtimi i Kompleksit (Rezidencave) Qeveritar" Prishtinë, Zonat Kadastrale: Prishtinë, Zllatar, Matiqan, Hajvali, Çagllavicë, Komuna e Prishtinës dhe Zonat Kadastrale: Graqanicë dhe Badovc, Komuna e Graqanicës, sipas tabelave të cilat janë pjesë përbërëse e këtij vendimi të bashkëngjitur në Aneksin I dhe II.
2. Aneksi I përmban tabelat e pronave të cilat anulohen nga zona e interesit të shpallur me Vendimin Nr. 03/41 datë 13.04.2018, përkatësisht parcelat në zonat kadastrale Prishtinë, Matiqan, Çagllavicë, Zlatar dhe Hajvali të Komunës së Prishtinës si dhe zona kadastrale Badovc, Komuna e Graqanicës.
3. Ankesi II përmban tabelat e pronave të cilat përfshihen brenda zonës së interesit të shpallur me Vendimin Nr.03/41 datë 13.04.2018, përkatësisht parcelat në zonat kadastrale Prishtinë, Matiqan, Hajvali, Çagllavicë, Zlatar të Komunës së Prishtinës dhe zona kadastrale Graqanicë, Komuna e Graqanicës.
4. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Komuna e Prishtinës dhe Komuna e Graqanicës.
5. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit dhe shpallet në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Ramush HARADINAJ**

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë

# Republika e Kosovës

## Republika Kosova - Republic of Kosovo

*Qeveria - Vlada - Government*

**Nr. 15/76**
**Datë: 21.11.2018**

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. të nenit 93 paragrafi (4) dhe të nenit 17 paragrafi 1. të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 4 paragrafi 2. të Ligjit Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 14/2017, me Rregulloren nr. 15/2017, me Rregulloren nr. 16/2017, me Rregulloren nr. 07/2018 dhe me Rregulloren nr. 22/2018, si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 21 nëntor 2018, nxjerr këtë:

## V E N D I M

1. Aprovohet në parim Nisma e Ministrisë së Financave për negocimin e Protokollit ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës, e përfaqësuar nga Ministria e Financave e Kosovës, dhe Qeverisë së Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë të Shqipërisë për Kryerjen e Veprimtarive të Përbashkëta të Kontrollit Doganor në Pikën e Përbashkët të Kalimit Kufitar Morinë/Vërmicë.

2. Përgjatë negocimit të kësaj marrëveshjeje, Ministria e Financave obligohet të procedojë konform dispozitave të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të Ligjit për Marrëveshjet Ndërkombëtare dhe dispozitave tjera ligjore në fuqi.

3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Ramush HARADINAJ**

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**
*Qeveria - Vlada - Government*

**Nr. 16/76**
**Datë: 21.11.2018**

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 14/2017, me Rregulloren nr. 15/2017, me Rregulloren nr. 16/2017, me Rregulloren nr. 07/2018 dhe me Rregulloren nr. 22/2018, si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 21 nëntor 2018, nxjerr këtë:

# V E N D I M

1. Ndahen mjete financiare në vlerë 500,000 (pesëqind mijë) euro, për Kombëtaren e Kosovës në Futboll.

2. Mjetet nga pika 1. e këtij vendimi do të sigurohen nga buxheti i Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, dhe do ndahen me një vendim tjetër të Qeverisë për ridestinim.

3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Ramush HARADINAJ**

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**
***Qeveria - Vlada - Government***

**Nr. 17/76**
**Datë: 21.11.2018**

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 3 të Ligjit për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 14/2017, me Rregulloren nr. 15/2017, me Rregulloren nr. 16/2017, me Rregulloren nr. 07/2018 dhe me Rregulloren nr. 22/2018, si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, kërkesa e Ministrisë së Drejtësisë nr. 02-4215, datë 16.11.2018, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 21 nëntor 2018, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

1. Aprovohet propozimi i Ministrisë së Drejtësisë për inicimin e procedurave ligjore për përzgjedhjen e përfaqësuesit të autorizuar për mbrojtjen e interesave të Republikës së Kosovës pranë arbitrazhit (ICSID) në çështjen nr. ARB/17/25 Mabco Constructions SA vs. Republika e Kosovës, lidhur me çështjen e tërheqjes së aksioneve nga AKP-ja tek NewCo Grand Hotel.

2. Autorizohet Ministria e Drejtësisë që, për shkak të natyrës urgjente të çështjes në arbitrazh, të ushtrojë procedurat e negociuara pa publikimin e njoftimit të kontratës për të përzgjedhur përfaqësuesin e autorizuar si nga pika 1. e këtij vendimi.

3. Obligohet Ministria e Drejtësisë, që për qëllim të zbatimit të obligimeve që rrjedhin nga pika 2. e këtij vendimi, të koordinojë dhe bashkërendojë punën me përfaqësuesit përkatës nga:
   - Zyra e Kryeministrit,
   - Ministria e Financave;
   - Agjencia Qendrore e Prokurimit;
   - Agjencia Kosovare e Privatizimit;

4. Obligohet Ministria e Financave që të bëjë ndarjen dhe zotimin e mjeteve financiare për mbulimin e shpenzimeve të përfaqësimit të jashtëm kontraktual.

5. Obligohen institucionet nga pika 3. e këtij vendimi që në bashkërendim me Ministrinë e Drejtësisë të ndërmarrin të gjitha veprimet që rrjedhin nga përgjegjësia e tyre për zbatimin e këtij vendimi.

6. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Ramush HARADINAJ**

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**
*Qeveria - Vlada - Government*

---

**Nr. 18/76**
**Datë: 21.11.2018**

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 14/2017, me Rregulloren nr. 15/2017, me Rregulloren nr. 16/2017, me Rregulloren nr. 07/2018 dhe me Rregulloren nr. 22/2018, si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, me qëllim të plotësimit të Vendimit Nr. 03/64 të datës 11.09.2018, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 21 nëntor 2018, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

1. Për zhvarrimin e mbetjeve mortore të Heroit të Kombit Ilir Konushevci, nga Varrezat e Sharrës në Tiranë dhe mbetjeve mortore të Dëshmorit të Kombit Hazir Malaj, nga Varrezat e fshatit Tpla të Tropojës, dhe rivarrimin e tyre në Varrezat e Dëshmorëve në Prishtinë.

2. Institucionet e Republikës së Kosovës dhe Shqipërisë në bashkëpunim, do të ndërmarrin të gjitha veprimet e nevojshme sa i përket procedurave të zhvarrimit.

3. Obligohet Ministria për Forcën e Sigurisë së Kosovës dhe institucionet tjera kompetente për zbatimin e këtij vendimi.

4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Ramush HARADINAJ**

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë